



Streha

R A P O R T V J E T O R

2 0 1 5 - 2 0 1 6

Ky material është pjesë e projektit që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Ky raport u realizuar në kuadër të projektit “Advokimi i shërbimeve sociale nga organizatat e shoqërisë civile” me mbështetjen e një granti të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Programit Matra për Sundimin e Ligjit. Objektivat, zbatimi i duhur dhe rezultatet janë përgjegjësi e organizatës zbatuese - Qendra Streha. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura i përkasin organizatës zbatuese dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë ato të Qeverisë Hollandeze.

Tabela e Përmbajtjes

Letër e Kryetares së Bordit	2		
Letër e Drejtores Ekzekutive	3	Rrjetëzim dhe shkëmbim eksperiencash	9
Hyrje	4	Mekanizma Ligjorë	10
Objektiva Strategjike	4	Mbrojtja e të rinjve LGBTI të pastrehë	11
Anëtarët e Bordit	4	Histori Suksesi	12
Mbështetësit e Streha-s	5	Të drejtat e komunitetit LGBTI	14
Programe dhe aktivitete gjatë 2016	6	Programe të tjera	15
Ngritje e kapaciteteve institucionale	8	Programe për të ardhmen	15
		Stafi i Streha-s	15
		Raporte Financiare	16



Kingdom of the Netherlands



Astraea LESBIAN FOUNDATION FOR JUSTICE

Të nderuar kolegë e miq,

Gjatë punës sonë ndër vite jemi përballur me shumë të rinj në vështirësi. Ndaj dëshira për t'i ndihmuar dhe për t'i dhënë një drejtim jetës së dhjetëra të rinjve LGBTI të pastrehë, solli hapjen e Strehës. Kur në dhjetor të vitit 2014 Streha hapi dyert për përfituesit e parë të saj, askush nuk e dinte me siguri se çfarë impakti do të kishte ky shërbim në jetën e më të rinjve dhe më të përjashtuarve të komunitetit LGBTI në Shqipëri.

Streha erdhi si nismë e Alencës LGBT dhe Pro LGBT por sot, dy vjet më pas, ka arritur që të jetë një institucion i pavarur. Ky shërbim, jo vetëm që ka ndryshuar jetët e mbi 35 të rinjve të përjashtuar nga familja e shoqëria, por ka pasur e vazhdon të ketë impakt të drejtpërdrejtë në avancimin e lëvizjes për të drejtat e komunitetit LGBTI në Shqipëri. Të dhënat e marra nga Streha janë mjeti më i mirë për të kuptuar problemet me të cilat përballen të rinjtë LGBTI dhe cilat janë nevojat e tyre.

Të rinjtë që ia kanë dalë të ri-integrohen në shoqëri na kanë mësuar se nëse punojmë sot për të sfiduar diskriminimin, për të luftuar përjashtimin e për t'i thënë ndal dhunës në familje e më gjerë, do të kemi nesër një shoqëri më gjithëpërfshirëse. Një shoqëri që nuk e feston diversitetin por e konsideron atë si një rrezik, është një shoqëri që ecën në krahun e kundërt të historisë.

Por e gjithë kjo punë është bërë e mundur vetëm falë bashkëpunimit me institucionet publike, organizatat, bizneset dhe mbi të gjitha me aktivistët e lëvizjes për të drejtat e komunitetit LGBTI në Shqipëri.

Streha ka treguar arritje dhe ka përmbushur synimet e veta, falë kontributit nga Drejtoresha Ekzekutive znj. Marsida Çela dhe ekipit të palodhur të Strehës.

Dua të falenderoj me këtë rast ata që së bashku me mua dhe Kristin, hodhën gurin e parë për ngritjen e Strehës – Clare Masson, Michael Kane, Matty Timmy, Iva Sinani, Erjon Tela, Edlira Mara, Alba Ahmetaj, Livia Zotrija, Kejda Jahja e shumë të tjerë që në mënyrë të palodhur patën vizionin ta shndërrojnë Strehën në një shërbim të pavarur dhe të qëndrueshëm.

Unë besoj se 2017 do të jetë një vit suksesi për Qendrën Streha dhe shpresoj që ne do vazhdojmë të mbështetemi nga organizatat dhe institucionet lokale e ndërkombëtare.

Me respekt

Xheni Karaj

Kryetare e Bordit, Qendra Streha

Përrshendetje të gjithëve,

Ju falenderoj të gjithëve për mbështetjen ndaj Qendrës Streha-s si dhe ndaj përpjekjeve të vazhdueshme të institucionit për të ndërtuar një të ardhme më të fortë. Bashkëpunimi i komunitetit të biznesit, ndërgjegjësimi i institucioneve shtetërore, trupave diplomatike, përfaqësuesve të shtetit të organizatave ndërkombëtare, si dhe anëtarëve të komunitetit LGBT, kanë ndihmuar ata në nevojë të zhvillojnë aftësitë drejt pavarësisë dhe arritjes së ëndrrave të tyre.

Unë do të doja të bëja disa komente të shkurtra që janë shumë të rëndësishme për qendrën Streha, komunitetin LGBT dhe punën e Strehës.

Unë do të doja të falënderoj USAID-in dhe Albert Kennedy Trust për mbështetjen në krijimin e Strehës dhe punën e saj; Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për mbështetjen e punës së Strehës përmes Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile;

Falenderime të veçanta shkojnë për Ambasadën e Mbretërisë së vendeve të Ulëta, në kuadër të Programit Matra për sundimin e ligjit, Fondacionit Astrea, dhe Programin e Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë për mbështetjen publikimin e këtij raporti.

Gjithashtu, shumë falenderime shkojnë për figurat publike të lëvizjes LGBT në Shqipëri, Xheni Karaj nga Aleanca LGBT, Kristi Pinderi nga ProLGBT, të cilët kanë qenë mbështetës të qendrës Streha me

aktivizmin e tyre, pavarësisht angazhimit vetjak nëpër organizatat e tyre respektive. Me përpjekjet tona të bashkuara, qendra Streha ka hedhur hapa të mëdhenj.

Streha e kupton rëndësinë e ndërtimit të anëtarëve të fortë të komunitetit. Me përmbushjen e nevojave bazike dhe sigurimin e një hapësirë të sigurt për tu zhvilluar, përfituesit e Strehës marrin mbështetje mjekësore/ligjore, shërbime të këshillimit, trajnim profesional, dhe janë të lidhur me mundësitë e duhura të punësimit. Aktualisht mbi 35 raste të Strehës kanë nisur rrugën drejt lidhjeve më të forta me komunitetin dhe duke dhënë kontribute domethënëse.

Më shumë punë na pret përpara ndërkohë që ne këmbëngulim të sjellim ndërgjegjësim mbi presionin që ndodh brenda komunitetit LGBT në lidhje me shtëpitë e tyre, familjet, vendin e punës, si dhe hapësirat publike. Ne do të vazhdojmë të punojmë fort për të mbledhur referime për ata që janë në nevojë, si dhe të ndërtojmë punë të vazhdueshme në terren me institucionet.

Ju falenderoj të gjithëve edhe një herë për punën e bërë së bashku dhe për mbështetjen bujare të treguar ndaj Strehës.

Sinqerisht,
Marsida Cela
Drejtuese Ekzekutive

MISIONI YNË

“Streha” është një shërbim konkret tranzitor për të gjithë të rinjtë LGBTI nga moshë 18 deri 25 vjeç që përballen me kërcënimin e dëbimit nga shtëpitë e tyre (zakonisht në fazën e daljes hapur), ose për ata jeta e të cilëve është bërë e pamundur për shkak të kërcënimeve, dhunës në familje, diskriminimit dhe stigmës.

Hyrje

Rreth nesh

“Streha” është qendra e pare rezidenciale jo-publike në jug të Evropës Lindore, e cila ndihmon komunitetin LGBT në raste emergjente të strehimit dhe akomodimit. Ajo filloi si një projekt pilot i dy organizatave kryesore LGBT në Shqipëri, Aleanca kundër Diskriminimit LGBT në bashkëpunim me Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT, respektivisht që nga hapja e dyerve të saj në Dhjetor 2014.

“Streha” është aktive si një OJQ e pavarur që prej 13 Nëntorit të 2015, është një shërbim konkret tranzitor për të gjithë të rinjtë LGBTI nga moshë 18 deri në 25 që përballen me dhunën dhe diskriminimin nga familja ose komuniteti (zakonisht në fazën e coming out) duke ia vështirësuar tyre jetesën. Qendra Streha është e licencuar që nga Janari i vitit 2015 nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për të siguruar shërbime rezidenciale dhe sociale.

Të rinjtë nën 18 vjeç dhe mbi 25 vjeç, të cilët kanë nevojë për shërbimet e Strehës, vlerësohen rast pas rasti nga stafi i profesionistëve të qendrës.

Streha i siguron shërbime ri-integrimit të rinjve LGBT të pastrehë në

rrezik, përmes 8 anëtarëve të stafit, përgjatë 24 orëve, në 7 ditë të javës. Qendra “Streha” ka një kapacitet prej tetë shtretërish dhe synon të jetë një shërbim që ju vjen në ndihmë të rinjve në rrezik e të pastrehë LGBTI, në nivel kombëtar.

Një ekip multidisiplinar i qendrës “Streha” bën vlerësimin fillestar të secilit rast, dhe e pranon kërkesën për strehim në qendër bazuar në një protokoll të qartë dhe shumë rigoroz, i projektuar në përputhje me standardet kombëtare, me ndihmën e USAID dhe Assist Impact, të qendrave rezidenciale ekzistuese në Shqipëri dhe sidomos me ndihmën e rrjetit të strehave “Albert Kennedy Trust” në Britaninë e Madhe që punon që nga viti 1989.

Objektiva strategjike

- ◆ Përfituesit e qendrës Streha përfitojnë ndihmë emergjente dhe mbrojtje.
- ◆ Përfituesit e qendrës Streha kanë mundësi më të shëndosha re-integrimit dhe të rindërtimit të jetës së tyre.
- ◆ Qendra Streha ka tërhequr nëpërmjet punës në terren ofrues shërbimesh dhe përfitues të mundshëm.

Anëtarë Bordi

Xheni Karaj –Kryetare bordi

Delina Fico –Anëtare bordi

Vjollca Meçe – Anëtare bordi

Erjon Tela – Anëtar bordi

Sidita Zaja – Anëtare bordi

Mbështetësit e Streha

Streha është mbështetur nga individë dhe organizata të ndryshme që kanë siguruar mbështetje profesionale e të tjera. Streha i atribuon një pjesë të madhe të suksesit tonë mbështetësve tanë, të përkushtuar dhe të angazhuar ndaj organizatës sonë. Ne do të dëshironim të përmendnim këtu çdo individ që ka kontribuar, por lista do të ishte pothuajse e pafund. Ju lutem të keni parasysh se ne vlerësojmë secilin prej jush aq sa edhe këto organizata që ndihmuan për të krijuar, mbështetur dhe financuar programet dhe aktivitetet e Streha në 2015-2016:

USAID nëpërmjet ASSIST IMPACT

Albert Kennedy Trust

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë përmes AMSHC

Fondacioni ASTREA

Ambasada e Mbretërisë së Hollandës

Ambasada e SHBA-ve

Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT

Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT (ProLGBT)

Michael Kane përmes ProLGBT

Luke Dowding



Aktivitetet dhe Evente Bamiresie

Retreat për finalizimin e Rregullores dhe Manualit operacional

Më 13 Shkurt, 2016, u realizua një retreat me pjesëmarrjen e të gjithë stafit të STREHA me qëllim rishikimin dhe finalizimin e Rregullores dhe Manualit Operacional të funksionimit të shërbimit. Kjo u arrit në bashkëpunim me përfaqësues të jashtëm nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë si dhe me kontributin e vetë përfutuesve të cilët ishin të pranishëm gjatë retreat-it.



Aktivitetet dhe evente bamiresie

Mbrëmja Gala e bamirësisë



Galaja e parë e bamirësisë “Një shtëpi, shumë zemra” u organizua më 16 maj 2015 në Hotel Rogner, ku morën pjesë 122 persona. Event i bamirësisë ngjiti 492,387 Lek sipas grafikut të mëposhtëm, të cilat u përdorën për të mbuluar qiranë e institucionit deri në Korrik të vitit 2016. Event i bashkëorganizua nga Aleanca LGBT dhe ProLGBT. Kur Qendra Streha u regjistrua si një entitet i pavarur, ProLGBT i transferoi fondet e mbedhura strehëzës.






Shfaqja e SkaNDAL ishte një tjetër iniciativë bamirësie gjatë muajit shtator 2015. Streha bashkëpunoi me Kinema Millenium për të shfaqur dokumentarin SkaNDAL që i referohet lëvizjes LGBTI në Shqipëri. 12,625 lek u grumbulluan dhe u përdorën për ushqimin e përfutuesve.


Streha realizoi Galanë e dytë të bamirësisë “Përqafo Diversitetin, Mbështet Progresin” më 20 Maj 2016 në Pallatin e Brigadave, me qëllim për të mbështetur programin e asistencës së Strehës për personat LGBT. Të ardhurat e mbledhura prej 19,000 \$ janë përdorur për të mbështetur programin e koordinimit me komunitetin dhe institucionet dhe programin e ri-integrimit për punësim, formim profesional, kujdes shëndetësor dhe aftësim për jetën.



Type of incomes Gala 2016



Expenses VS Proceeds



Programe dhe aktivitete në 2015-2016

Ngritja e kapaciteteve institutacionale

**Trajnim me profesionistë rreth mekanizmit të
referimit për LGBTI**



Përveç shërbimit bazë, qendra Streha ka punuar gjerësisht për shpërndarjen e informacionit në 12 këshille rajonale në Shqipëri, në funksion të shërbimit të ofruar të rinjve të pastrehë LGBTI në rrezik për përjashtim social, për shkak të orientimit të tyre seksual. Mbi 300 ofrues

të shërbimeve sociale të njësive të qeverisjes vendore dhe këshillit të qarkut, shëndetësisë, arsimit, policisë, kanë qenë të informuar për shërbimet e Strehës. Stafi ka advokuar intensivisht përfshirjen e shërbimeve të saj në mekanizmin ekzistues të referimit të dhunës në famije. Ofruesit e shërbimeve kanë theksuar nevojën për trajnim në lidhje me çështjet LGBT, sidomos punonjësit socialë të shkollave dhe psikologët.



Shkëmbimi i eksperiencave

Takimi i Rrjetëzimit Ballkanik



Gjatë vitit 2016, më 2 dhe 3 Nëntor - Diakonie Kosova, Qendra Psikosociale për Terapinë e Traumas organizoi një takim të Rrjetit Ballkanik me profesionistë të ndryshëm të shëndetit mendor, përfaqësues të institucioneve të ndryshme dhe OJQ-ve nga vendet e Ballkanit.

Qendra Streha prezantoi punën e saj mbi trauman, historinë e përvojave kolektive traumatike, mekanizmat institucional në sigurimin e trajtimit profesional për personat LGBTIQ që janë të përjashtuar dhe viktimë të dhunës në familje dhe forma të tjera të dhunës.

Ky takim i Rrjetit Ballkanik ka pasur gjithashtu një mysafir të veçantë nga Qendra e Mbështetjes ndaj Traumës në Mynih të Gjermanisë, z Gabriela Heyers Specialiste në Mjekësinë Psikosomatike dhe Psikoterapi e cila i prezantoi grupit historinë e themelimit të Qendrës së saj dhe kushtet e

tanishme të punës së Qendrës si dhe dha ide të dobishme në përmirësimin e mëtejshëm të së nejtës punë që bëhet në Ballkan.

Takimi i rrjetit ballkanik u vlerësua me përfitim dhe interes nga pjesëmarrësit. Idetë e prezantuara për takime dhe advokim të mëtejshëm dhe ndryshimi i politikave për përmirësimin e shërbimeve të shëndetit mendor u bazua në kushtet dhe rrethanat aktuale të boshllëqeve institucionale dhe mundësi të kufizuara të OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve ndaj target grupeve.

Konferenca vjetore e ERA



Qendra Streha mori pjesë në konferencën e parë vjetore të Organizatës për të Drejtat e Barabarta LGBTI për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (ERA), në të cilën u diskutua për krijimin e urave lidhëse midis legjislacionit dhe komunitetit, duke u përqëndruar në çështjet e ndryshueshme të drejtësisë dhe në zbatimin e sjelljen e ideve, strategjive, modeleve që mund të përmirësojë nivelin e aplikimit të tyre.

Objektivi kryesor në konferencë ishte promovimi i një bashkëpunimi më të fortë dhe më të ngushtë ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe shtetërore me lëvizjet lokale për të drejtat e LGBT.

Simpoziumi i 5-të Ndërkombëtar Kundër Diskriminimit



Më 08-10 dhjetor 2016 Qendra Streha mori pjesë në Simpoziumin e 5-të Ndërkombëtar Kundër Diskriminimit në Ankara, Turqi. Aktiviteti u ndoq nga përfaqësues dhe punonjës socialë që punojnë me komunitetin LGBT, të cilët prezantuan arritjet dhe sfidat e punës së tyre të përditshme.

Simpoziumi theksoi nevojën e përfshirjes për edukimin mbi çështjet LGBT në kurrikulat akademike të punës sociale. Streha ofroi përvojën praktike, sfidat dhe sukseset, si dhe mënyrat për të përforcuar bashkëpunimin ndër - rajonal.



Mekanizma ligjorë

Qendra Streha ka marrë pjesë në nisjen e Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016-2020, i cili u zhvillua në Tiranë më 21 Tetor 2016. Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016-2020, ishte miratuar në Maj 2016.

Gjithashtu, takimi i parë i Zbatimit Kombëtar dhe Mekanizmit të Koordinimit (NICM), grupi i punës i ngarkuar me monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit të lartpërmendur, u mbajt në Tiranë.

Një nga qëllimet kryesore të Veprimit do të jetë lehtësimi i punës së NICM. Në këtë moment, Streha është i vetmi mekanizëm institucional në sigurimin e strehimit dhe akomodimit për të rinjtë LGBTI në rrezik dhe të pastrehë.



Mbrojtja e të rinjve LGBTI të pastrehë



Të rinjtë LGBTI në Shqipëri vuajnë nga diskriminimi dhe stigmatizimi për shkak të orientimit dhe identitetit të tyre seksual. Në shumë raste ata janë kërcënuar me dëbim nga shtëpia, sidomos gjatë fazës së coming-out, ose jetesa e tyre është bërë e pamundur për shkak të diskriminimit të vazhdueshëm dhe dhunës brenda familjes.

Qendra Streha është shërbimi i parë në rajon që merr përsipër të sigurojë strehim, siguri dhe mbrojtje për të rinjtë LGBTI në rrezik dhe të pastrehë. Vendndodhja e qendrës është konfidenciale dhe çdo informacion në lidhje me përfituesit, ose me ata që punojnë aty është reptësisht i ndaluar. Këto masa janë të nevojshme për të ruajtur konfidencialitetin dhe për të garantuar sigurinë e të gjithë personave LGBT të cilët janë strehuar aty.

Shërbimet

- ◆ Akomodim për 6 muaj (deri në 1 vit në varësi të shkallës së vërshirësisë dhe problematikës së rastit)
- ◆ Plane Individuale Zhvillimi
- ◆ Referime pranë shërbimeve më të profilizuara
- ◆ Formim Profesional
- ◆ Aftësim për jetën
- ◆ Këshillim Karriere
- ◆ Asistencë Mjekësore
- ◆ Mbështetje psiko-sociale
- ◆ Terapi individuale dhe në grup
- ◆ Negocim për punësim
- ◆ Negocim me Familjen

Për të referuar raste ju mund të kontaktoni në:

Web: www.strehalgbt.al
Tel: +355699839189
Email: sos@strehalgbt.al
info@strehalgbt.al
ndihme@strehalgbt.al

Faqen Strehës: www.facebook.com/strehalgbtshqiperi/
Llogarinë Qendra Streha: www.facebook.com/streha.albania?fref=ts



Rastet e mbështetura nga Streha

	L	G	B	T	Q	Total
2014-2015	4	4	2	1	1	12
2015-2016	7	7	4	4	1	23

Tabela nr 1. Shpërndarja e përfituesve sipas orientimit dhe identifikimit seksual

Duke iu referuar tabelës së mësipërme, Streha ka mbështetur 12 raste gjatë 2014-2015 dhe 23 raste gjatë 2015-2016.

Histori Suksesi

Historia e Berti't


Berti hyri tek Streha në një periudhë krize psikologjike që e coi atë drejt disa përpjekjeve serioze për vetvrasje. Pasi hyri në shërbimin e Strehës ai u diagnostikua nga psikiatrja me Depresion Madhorë. Ai vuante shumë emocionalisht për shkak të traumave të kaluara dhe për shkak të vështirësive në pranimin nga të tjerët të orientimit të tij seksual. Stafi i Strehës ishte thellësisht i përfshirë dhe mjaft i kujdesshëm në parandalimin e situatave të rrezikshme, për shkak të sjelljeve të tij vetdëmtuese dhe tentativave të mëparshme vetvrasëse. Ai mori kujdes psikologjik intensiv kombinuar me një recetë anti-depresantësh të përshkruar nga psikiatri. Nga ana tjetër ai ishte një student i talentuar, me një pasion të vecantë për politikën dhe aktivizmin social. Të gjitha këto pika të forta dhe mjaft të vlefshme, u përdorën nga profesionistët e Strehës me qëllimin për ta ndihmuar të përballojë të gjitha vështirësitë psikologjike. Berti u ndihmua nga Streha për të vazhduar studimet e tij dhe aktivizmin social. Ai qëndroi në Strehë për gjashtë muaj dhe pastaj u mbështet në distancë për gjashtë muaj të tjerë. Berti tani punon në një punë të qëndrueshme, ai po vazhdon studimet e tij dhe është thellësisht i përfshirë në aktivizëm social duke marrë pjesë në mënyrë aktive në shumë nisma të rëndësishme të shoqërisë civile. Pas më shumë se një vit terapie, të ofruar nga psikologu i Strehës, ai gjeti stabilitet emocional dhe tani ndihet më mirë pavarësisht sfidave të tij të vazhdueshme.



Historia e Enkelejda's


Enkelejda ishte 21 vjeç kur hyri në Strehë. Ajo e identifikon veten si biseksuale dhe ishte në një marrëdhënie të gjatë dhe të qëndrueshme me një vajzë. Kur familja e saj mori vesh për orientimin e saj seksual, ata reaguan shumë agresivisht duke e mbyllur atë brenda. Ajo u ndihmua nga e dashura e saj për të rënë në kontakt me shërbimet e Strehës. Pasi u takua nga punonjësi i ndihmës, duke konsideruar nevojën emergjente të saj për ndihmë, u pranua menjëherë në shërbim. Në fillim të qëndrimit të saj në Strehë ajo po përballej me disa çështje ankthi. Pas gjetjes së stabilitetit emocional, Enkelejda filloi të shikojë për punë. Ajo gjeti shumë shpejt një punë të përshtatshme për të dhe ishte shumë e përfshirë në punën e saj të re. Ajo u mbështet që të kontaktonte sërish familjen dhe filloi të komunikonte me nënën e saj. Enkelejda i kërkoi të ëmës që të pranonte orientimin e saj seksual. Ajo u ndihmua me çështjet e saj të ankthit dhe gjithashtu qëndra Strehë e ndihmoi Enkelejdën që të merrte ndihmë mjekësore për disa probleme kronike të shëndetit. Ajo qëndroi në Strehë edhe tre muaj të tjera pasi u punësua.

Për shkak të performancës shumë të mirë në profesionin e saj, ajo pati sukses në gjetjen e një pune e cila ishte shumë më e paguar. Enkelejda jeton tani në mënyrë të pavarur, ajo është mjaft e suksesshme në punën e saj dhe gjithashtu marrëdhënia me familjen e saj është përmirësuar ndjeshëm.



Historia e Moza's

Moza ishte 23 vjeçe kur aplikoi për të hyrë në shërbimin e Strehës. Ajo e identifikoi veten si biseksuale. Moza kishte disa vështirësi përse i përket strehimit dhe gjithashtu po përballej me disa vështirësi psikologjike. Ajo u ndihmua nga Qendra Strehë për të marrë lejen e qëndrimit në Shqipëri, duke qënë se nuk ishte shtetase shqiptare. Ajo vazhdoi këshillimin psikologjik rregullisht duke adresuar disa çështje të së kaluarës dhe disa sfida që po haste në atë moment. Moza ishte një studente shumë e mirë dhe ishte shumë e apasionuar pas profesionit të saj. Ajo u mbështet nga Strehë për të vazhduar studimet e saj. Ajo qëndroi për gjashtë muaj në Strehë. Tani ajo jeton në mënyrë të pavarur dhe herë pas here kontakton me punonjësit e Strehës. Ajo po vazhdon universitetin me rezultate të shkëlqyera dhe po ndjek ëndrrën e saj për tu bërë një artiste.



Të drejtat LGBT

Njerëzit në mbarë botën përballen me dhunën dhe pabarazinë dhe ndonjëherë edhe torturën ose ekzekutimin për shkak të cilit ata dashurojnë, si duken apo si janë. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë aspekte të integruara të vetes sonë dhe nuk duhet të cojnë kurrë në diskriminim ose abuzim.

Lesbiket, gejt, biseksualët dhe transgjinatorët (LGBT) në Shqipëri mbrohen me ligj nën një legjislacion kundër diskriminimit. Si meshkujt dhe femrat seksualisht aktiv me persona të të njëjtit seks janë të ligjshëm në Shqipëri por familjet e cifteve të të njëjtit seks ende nuk kanë të drejtë për të njëjtat mbrojtje ligjore në dispozicion të çifteve të gjinive të kundërta.

Shqipëria në përgjithësi konsiderohet ende si konservatore, vecanërisht në reagimet e publikut rreth të drejtave LGBT dhe të prezencës së personave LGBT, megjithatë legjislacioni anti diskriminim ka bërë që ILGA-Europë të listojë Shqipërinë si një nga vendet e pakta në Europë që dënon specifikisht diskriminimin me bazë identiteti gjinor.

Shqipëria ka ratifikuar Protokollin nr 12 të Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave Themelore, dhe më tej Shqipëria ka firmosur në Deklaratën e OKB mbi Orientimin Seksual dhe Identitetit Gjinor në 2007.

Ligje të mëparshme kundër homoseksualitetit

Shqipëria ka dekriminalizuar homoseksualitetin në vitin 1995. Mosha e pranimit është 14 për të gjithë, pavarësisht nga gjinia dhe / ose orientimi seksual që nga 2001, moshë pranimi në Europë.

Njohja e marrëdhënieve mes seksit të njëjtë

Martesa mes të njëjtës gjini apo sindikatat civile nuk janë të njohura për momentin në Shqipëri. Edhe pse ish- kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha njoftoi në Korrik 2009 se ai do të mbështesë njohjen e martesave civile në çiftet e të njëjtit seks, ligji i ri, i miratuar më 4 Shkurt 2010 nuk parashikoi martesat mes të njëjtit seks.

Mbrojtje nga Diskriminimi

Më 4 Shkurt 2010, Parlamenti Shqiptar miratoi njëzëri një ligj gjithëpërfshirës kundër diskriminimit i cili ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Ligji ndalon diskriminimin në të gjitha fushat, duke përfshirë punësimin, ofrimin e mallrave dhe shërbimeve, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe strehimin.

Situata për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut luftojnë për t'u dëgjuar. Shpesh politikanët dhe mediat i kanë diskredituar mendimet dhe rekomandimet e tyre. Media nuk konsiderohet e lirë dhe e pavarur. Mbrojtësit LGBTI të drejtave të njeriut të tilla si "Aleanca kundër Diskriminimit LGBT" dhe "Pro LGBT" shpesh përballen me barriera të forta shoqërore dhe kulturore gjatë kryerjes së punës së tyre.

Dhjetë të drejtat me fokus advokimin e të drejtave të njeriut

*E drejta për
jetën dhe
integritetin
fizik*

*E drejta për
lininë dhe
sigurinë e
personit*

*E drejta për
respektimin e
jetës private
dhe jetës
familjare*

*E drejta për
gjykim të
drejtë dhe
për mjete të
efektshme*

*E drejta
e lirisë së
mendimit,
ndërgjegjes
dhe besimit*

*E drejta
e lirisë së
shprehjes*

*E drejta
e lirisë së
tubimit dhe
e organizimit*

*Të drejtat
për mbrojtje
kundër gjuhës
së urrejtjes dhe
propagandës
së luftës*

*E drejta për
të drejtat
politike*

*E drejta për
mbrojtjen nga
diskriminimi*

Programe të tjera

Programe të ardhshme

Menaxhimi i rasteve në distancë është një projekt i ardhshëm i programuar për tu ardhur në ndihmë të rinjve LGBT në rrezik e të pastrehë, por që kanë të zgjidhur çështjen e strehimit ose që nuk përmbushin kriterin e moshës. Këtyre përfituesve do tu sigurohet ndihmë për një periudhë nga 3 deri në 6 muaj, duke u mbështetur vazhdimisht nga një staf profesional i cili do vlerësojë dhe asistojë nevojat e tyre.

Menaxhimi i rasteve në distancë do të jetë një alternativë për të ndihmuar LGBTI në nevojë përtej kapacitetit aktual të Strehës. Të rinjtë LGBT që do të mbështeten në këtë projekt do të jenë nën mbikqyrje të vazhdueshme nga punonjësit e rasteve, të cilët do të monitorojnë ndjekjen e planit individual të zhvillimit për secilin prej përfituesve.

Staf

Marsida Cela
Drejtores Ekzekutive

Merita Kaca
Punonjëse Sociale

Stivi Shehu
Kujdestare Sociale

Xhesi Demishago
Financë dhe Oficere Admin

Elvis Popaj
Psikolog

Edlira Mara
Koordinatorë Terreni


Esmeralda Kumanaku
Kujdestare Sociale

Dalila Davidhi
Kujdestare Sociale

Pasqyra financiare 2015


Burimi i të ardhurave 2015

Nr	Burimi i të ardhurave 2015	Vlera (%)
1	Assist Impact	71.42%
2	Fundraising 2015 nëpërmjet ProLGBT	18.66%
3	Michael Kane nëpërmjet ProLGBT	9.92%
4	Të ardhura nga interesi	0.00%



Shpenzime 2015

Nr	Shpenzime 2015	Vlera (%)
1	Ushqimi	15%
2	Shpenzime uji	1%
3	Plani individual i vlerësimit	8%
4	Strehimi	40%
5	Koordinim terreni	9%
6	Produkte jetësore të rezidenteve	7%
7	Shpenzime bankare	1%
8	Shpenzime të tjera operative	19%
9	Shpenzime për interesa	0%




Shënim: Shpenzimet e tjera operative përfshijnë kostot e komunikimit, kostot e zyrës dhe kostot administrative

Pasqyra financiare 2016

Burimi i të ardhurave 2016

Nr	Burimi i të ardhurave 2016	Vlera (%)
1	Assist Impact	19.7%
2	Astrea Foundation përmes Aleanca LGBT	13.72%
3	Astrea Foundation	19.95%
4	Shfaqja e SkaNdal në Kinema Millenium	0.07%
5	Gala 2016	16%
6	Programi i Granteve të vogla, Ambasada e SHBA-ve	3.47%
7	Ambasada Hollandeze	29.44%
8	Luke Peter Dowding	0.55%
9	Eventi OSAAB	0.21%
10	CEL Kosovo	2.91%



Shpenzime 2016

Shënim: Shpenzimet e tjera operative përfshijnë trajnime të stafit për standartet kombëtare të shërbimit social, mbledhje stafi për realizimin e Manualit operacional, programi financiar, kosto administrative të licencës dhe shpenzimet për eventin e ngritjes së fondeve (Gala 2016).

Nr	Shpenzime 2016	Vlera (%)
1	Ushqimi	10.75%
2	Produkte jetësore të rezidentëve	1.81%
3	Strehimi	10.20%
4	Plani individual i vlerësimit	4.98%
5	Asistencë Mjekësore	8.14%
6	Konsulencë Sociale	6.44%
7	Shërbim formimi profesional	7.22%
8	Aftësim në jetë dhe edukim social	7.65%
9	Ndërmjetim për punësim	12.49%
10	Këshillim karriere	4.46%
11	Këshillim Psikologjik	5.13%
12	Terapi arti	4.03%
13	Mbështetje ligjore	2.44%
14	Koordinim terreni	2.31%
15	Shpenzime të tjera operative	11.95%

